



Oda e Infermierëve, Mamive dhe
Profesionistëve tjerë Shëndetësor

Shëndeti dhe Kujdesi Infermieror

Nr. 6 / Qershor, 2026



OIK siguron mbrojtje juridike dhe sigurime shëndetësore për anëtarët

Nga 1 korriku 2026, anëtarët e OIK-ut do të përfitojnë shërbime juridike dhe sigurime shëndetësore të jetës, që mbulojnë kontestet e punës, çështjet pensionale, sëmundjet e rënda, trajtimet spitalore dhe rastet e aksidenteve. (Fq. 10)



**Nga duart që presin lindjen
te zemrat që japin shpresë**
(Fq. 3)



**Infermierët mirëpresin
sigurimet jetësore** (Fq. 8)



**Këshilli etik, mbrojtës i
vlerave profesionale dhe
dinjitetit në shëndetësi** (Fq. 12)



Oda e Infermierëve, Mamive dhe
Profesionistëve tjerë Shëndetësor

**Oda e Infermierëve, Mamive
dhe profesionistëve të tjerë
shëndetësor - OIK**

www.oik-ks.org
revistaoik@gmail.com
Rr. "Holger Pedersen",
Prishtinë 10000, Kosovë

Kryetare e OIK
Nexhmije Gori

Kryeredaktor
Muharrem Arifi

Zv. Kryeredaktorë
Lirije Beqiri
Donika Shahini Lami

Anëtarë të redaksisë
Xhavit Ramadani
Rexhep Jakaj
Feim Hasani

Lektor
Xhavit Ramadani

**Distribrimi online dhe
radhitje kompjuterike**
Besian Hajrizi

Shtypi:
Tirazhi: 500 copë

Revista jepet falas!

Prishtinë, Qershor 2026

Editorial

OIK forcoi mbrojtjen profesionale përmes shërbimeve të reja



Muharrem Arifi,
Kryeredaktor

Vendimi i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK) për të ofruar paketa të integruara të shërbimeve juridike dhe sigurimeve shëndetësore të jetës nga 1 korriku 2026, përfaqëson një hap të rëndësishëm në drejtim të reformimit të brendshëm institucional dhe forcimit të mbrojtjes së anëtarëve të saj.

Kjo nismë nuk duhet parë thjesht si një shtesë shërbimesh administrative, por si pjesë e një reforme më të gjerë që synon të rrisë standardin e përfaqësimit profesional dhe të garantave sociale për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë.

Në thelb të kësaj reforme qëndron ideja se profesionistët shëndetësorë, të cilët përballen çdo ditë me përgjegjësi të lartë dhe rreziqe të shumta në punë, duhet të kenë një mekanizëm të fortë mbrojtës jo vetëm profesional, por edhe juridik dhe financiar. Përfshirja e përfaqësimit ligjor në konteste pune, çështje pensionale, procedura disiplinore dhe mbrojtje të integritetit profesional, përbën një avancim të dukshëm në funksionimin e OIK-ut si institucion përfaqësues.

Po aq e rëndësishme është edhe komponenta e sigurimeve shëndetësore dhe të jetës, e cila synon të ofrojë një rrjet sigurie në raste të rënda sëmundjesh, aksidentesh apo humbesh jetësore. Në një sistem shëndetësor ku rreziku profesional është i përditshëm, një mekanizëm i tillë solidariteti dhe mbrojtjeje financiare përbën një nevojë reale.

Megjithatë, suksesi i kësaj reforme do të varet nga mënyra e

zbatimit të saj në praktikë. Transparenca në menaxhimin e fondeve, qartësia e procedurave të përfitimit dhe efikasiteti i ofrimit të shërbimeve do të jenë faktorët kyç që do të përcaktojnë nëse kjo nismë do të mbetet një deklaratë e mirë qëllimi apo do të shndërrohet në një standard të ri të mbrojtjes profesionale.

Nga ana tjetër, ndryshimet në sistemin e pagesës së anëtarësisë duhet të shoqërohen me llogaridhënie të plotë dhe komunikim të vazhdueshëm me anëtarët, në mënyrë që kontributi i tyre të perceptohet si investim në sigurinë dhe dinjitetin profesional, e jo si barrë shtesë financiare.

Në këtë kuptim, kjo reformë e OIK-ut përfaqëson një test të rëndësishëm institucional, jo vetëm për aftësinë e saj organizative, por edhe për gatishmërinë për të ndërtuar një model më modern dhe më të qëndrueshëm të mbrojtjes së profesionistëve shëndetësorë në vend.



Reportazh: Në shërbim të jetës

Nga duart që presin lindjen te zemrat që japin shpresë

Reportazh nga **Donika Shahini Lami**

Muaji maj, i njohur në mbarë botën si periudha kushtuar infermierëve dhe mamive, u shënuar edhe tek ne me aktivitete që nxorën në pah rolin e pazëvendësueshëm të këtyre profesionistëve në sistemin shëndetësor.

Dita Ndërkombëtare e Mamive, më 5 maj, dhe Dita Ndërkombëtare e Infermierisë, më 12 maj, sollën jo vetëm momente reflektimi mbi rëndësinë e këtyre profesioneve, por edhe mesazhe të fuqishme për mbështetje më të madhe institucionale dhe shoqërore.

Në një ceremoni solemne që shënoi Ditën Ndërkombëtare të Mamive dhe njëkohësisht hapi zyrtarisht Javën e Infermierisë, vëmendja u përqendrua tek misioni fisnik i mamive dhe infermierëve, profesionistë që qëndrojnë pranë njeriut në çastet më të rëndësishme të jetës nga lindja e një foshnjeje deri tek kujdesi për pacientët në momentet më sfiduese të tyre.

Në qendër të mesazheve të përcjella gjatë aktiviteteve ishte vizioni për forcimin e profesioneve shëndetësore dhe ngritjen e vazhdueshme të dinjitetit profesional të infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë.

Kryetarja e OIK-ut, Nexhmije Gori, theksoi se këto profesione nuk përfaqësojnë vetëm një hallkë të rëndësishme të sistemit shëndetësor, por janë vetë 'zemra' e tij, pasi janë profesionistët që qëndrojnë më afër pacientit në çdo fazë të trajtimit dhe kujdesit.

Mamitë dhe infermierët, zëri përfaqësues i mijëra profesionistëve shëndetësorë në vend

Ajo nënvizoi se misioni i mamive dhe infermierëve shkon përtej detyrës profesionale, duke përfshirë përkushtimin njerëzor, empatinë dhe gatishmërinë për të qenë pranë qytetarëve në momentet më të rëndësishme dhe më të vështira të jetës së tyre.

"Kur flasim për mamitë, flasim për profesionistë që presin jetën në çastet e para të saj. Kur flasim për infermierët, flasim për ata që qëndrojnë pranë pacientit ditë e natë, shpeshherë duke u bërë mbështetja më e madhe morale dhe profesionale për të dhe familjen e tij. Kjo është arsyeja pse këto profesione meritojnë respekt, vlerësim dhe mbështetje të vazhdueshme", theksoi ajo.

Sipas saj, OIK-u gjatë viteve të fundit ka punuar vazhdimisht për fuqizimin profesional të anëtarësisë, mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe avancimin e standardeve të profesionit, duke u bërë zëri përfaqësues i mijëra profesionistëve shëndetësorë në vend.

Duke folur për iniciativat e reja të prezantuara gjatë ceremonisë, Gori vlerësoi se ofrimi i shërbimeve juridike dhe sigurimeve jetësore për anëtarët paraqet një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një mbështetjeje më të plotë institucionale për profesionistët shëndetësorë.

Ajo theksoi se profesionistët shëndetësorë duhet të ndihen të mbrojtur jo vetëm në aspektin profesional, por edhe në atë ligjor dhe social, në mënyrë që të mund ta ushtrojnë profesionin e tyre me siguri dhe dinjitet.

"Një sistem shëndetësor i fortë nuk ndërtohet vetëm me pajisje moderne apo infrastrukturë. Ai ndërtohet mbi njerëzit, mbi profesionistët që çdo ditë mbajnë barrën e kujdesit për qytetarët. Investimi në infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë është investim në shëndetin dhe të ardhmen e shoqërisë sonë", u shpreh ajo.

Në fjalimin e mbajtur u theksua se infermierët dhe mamitë përbëjnë shtyllën kryesore të sistemit shëndetësor, duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me pacientët dhe familjet e tyre. Përtej njohurive profesionale, puna e tyre kërkon empati, durim dhe gatishmëri për t'u përballur me situata të ndryshme njerëzore.

Një moment i veçantë i aktivitetit ishte ndarja e mirënjohjeve për profesionistë të dalluar nga institucione të ndryshme shëndetësore. Në sallën Qendres Kombëtare të Telemedicinës së Kosovës, mbizotëronte një atmosferë emocionesh, krenarie dhe respekti për ata që për vite me radhë kanë shërbyer me përkushtim në kujdesin ndaj pacientëve.

Për shumë prej të nderuarve, ky vlerësim përfaqësonte jo vetëm një mirënjohje personale, por edhe një vlerësim për gjithë kolegët me të cilët ndajnë përditshmërinë profesionale.

"Ky vlerësim është një motivim i madh. Ai i takon çdo kolegu me të cilin kemi kaluar sfida, net pa gjumë dhe momente të vështira në shërbim të pacientëve. Është një ndjenjë krenarie kur puna jote vlerësohet", tha njëra nga përfitueset e mirënjohjes.

Një tjetër profesioniste e nderuar theksoi se shpërblimi më i madh mbetet gjithmonë mirënjohja e pacientëve.

"Ka lodhje, sakrificë dhe ngarkesë emo-



cionale, por çdo herë kur sheh një pacient të rikuperuar ose një familje të lumtur, kupton pse e ke zgjedhur këtë profesion.

shërbimeve juridike për profesionistët shëndetësorë, duke siguruar këshillim dhe mbështetje në rastet e kontesteve në vendin e punës apo procedurave disiplinore.

Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë, mesazhi i kujdesit dhe solidaritetit mori formë konkrete. Kryetarja Nexhmije Gori



Sipas drejtuesve të Odës, kjo është një nevojë e kahershme e profesionistëve shëndetësorë, të cilët shpesh përballen me situata të ndërlikuara gjatë ushtrimit të detyrës së tyre dhe kanë nevojë për mbështetje profesionale e ligjore.

Po ashtu, u bë e ditur se është arritur marrëveshje për sigurime jetësore për anëtarët, një hap që synon të ofrojë më shumë siguri financiare për familjet e tyre dhe mbrojtje shtesë për vetë profesionistët.

Kjo është forca që na shtyn të vazhdojmë", u shpreh ajo.

Gjatë aktivitetit u prezantuan edhe dy iniciativa të reja në mbështetje të anëtarëve të Odës. E para ka të bëjë me ofrimin e

Këto iniciativa u mirëpritën nga të pranishmit, të cilët i vlerësuan si hapa konkretë drejt përmirësimit të mirëqenies dhe sigurisë së profesionistëve shëndetësorë.

Vetëm një javë më vonë, më 12 maj, në



së bashku me stafin profesional të OIK-ut dhe anëtarë të organeve drejtuese, zhvilluan një aksion vullnetar për dhurim gjaku në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku.



Dhurimi i gjakut, akt i pastër humanizmi dhe solidariteti

Ky veprim simbolik dhe human u mirëprit nga stafi i qendrës dhe u vlerësua si një dëshmi se infermierët dhe mamitë

vazhdojnë të jenë në shërbim të jetës jo vetëm në vendet e tyre të punës, por edhe përmes iniciativave që ndihmojnë drejtpërdrejt qytetarët.

Përfaqësuesit e OIK-ut theksuan se dhurimi i gjakut është një akt i pastër humanizmi dhe solidariteti, vlera që janë të mishëruara në vetë profesionin e infermierisë.

"Ne kujdesemi për jetën çdo ditë. Dhurimi i gjakut ishte një mënyrë për ta dëshmuar edhe një herë këtë përkushtim dhe për të dhënë një mesazh sensibilizues për të gjithë qytetarët që kanë mundësi të bëhen dhurues vullnetarë", tha një nga pjesëmarrësit në aksion.

Java e Infermierisë shërbeu gjithashtu si një platformë për të diskutuar sfidat me të cilat përballen profesionistët shëndetësorë në Kosovë. Në mesin e çështjeve më të përmendura ishin ngarkesa në punë, nevoja për më shumë investime në resurset njerëzore, zhvillimi profesional i vazhdueshëm dhe krijimi i kushteve më të mira të punës.



Megjithatë, pavarësisht sfidave, mesazhi që dominoi gjatë gjithë aktivitetëve ishte ai i krenarisë profesionale, i përkushtimit ndaj pacientit dhe i besimit se profesioni i infermierisë dhe mamisë mbetet një nga shtyllat më të forta të sistemit shëndetësor.

Në fund të aktivitetëve, mesazhi i përcjellë ishte një mesazh falënderimi dhe mirënjohjeje për të gjithë profesionistët shëndetësorë që me punën e tyre të përditshme vazhdojnë të dëshmojnë profesionalizëm, humanizëm dhe përgjegjësi të lartë shoqërore.

Sepse pas çdo lindjeje të sigurt, pas çdo pacienti të trajtuar dhe pas çdo jete të



shpëtuar, qëndrojnë njerëz që punojnë larg vëmendjes së publikut, por që mbeten ndër figurat më të rëndësishme të kujdesit shëndetësor. Mamitë dhe infermierët vazhdojnë të jenë fytyra e kujdesit, zëri i shpresës dhe dora që nuk mungon kurrë kur dikush ka më së shumti nevojë për ndihmë.





Intervistë me z. Lulzim Gashi, Udhëheqës i Divizionit të Infermierisë në SHSKUK

Reformimi i infermierisë drejt standardizimit, me pacientin në qendër

Feim Hasani

Prishtinë, qershor 2026

Në një periudhë kur sistemi shëndetësor po përballet me sfida të shumta strukturore dhe profesionale, roli i infermierisë mbetet thelbësor në garantimin e kujdesit cilësor për pacientët. Mungesa e stafit, ngarkesa e lartë e punës dhe nevoja për standardizimin e procedurave janë disa nga çështjet që kërkojnë adresim të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm. Udhëheqësi i Divizionit të Infermierisë në SHSKUK, z. Lulzim Gashi, flet për sfidat aktuale dhe vizionin e tij për një sistem shëndetësor më efikas dhe më të unifikuar.

Revista: Z. Gashi, cili është vizioni juaj konkret për infermierinë në SHSKUK për 2–3 vitet e ardhshme?

Lulzim Gashi: Vizioni im është ndërtimi i një sistemi infermieror të unifikuar dhe të organizuar, me standarde të njëjta në të gjitha klinikat dhe spitalet e SHSKUK-së. Synimi është të kemi staf më të motivuar dhe pacientin në qendër të kujdesit, me fokus të veçantë në cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve.

Revista: Cilat janë tri problemet kryesore që i keni identifikuar menjëherë pas marrjes së detyrës?

Lulzim Gashi: Mungesa e stafit infermieror, ngarkesa e lartë e punës, e cila shkakton sindromën e djegies profesionale (burnout), si dhe mungesa e standardizimit të detyrave dhe e mbikëqyrjes së njëtrajtshme në të gjitha njësitë.

Revista: Çfarë do të ndryshoni ndryshe nga drejtuesit e mëparshëm?

Lulzim Gashi: Më shumë llogaridhënie, vendimmarrje të bazuar në të dhëna dhe përfshirje reale të stafit infermieror në proceset vendimmarrëse.

Revista: A është i mjaftueshëm numri aktual i infermierëve në SHSKUK?

Lulzim Gashi: Jo. Në shumë njësi ka mungesë të theksuar të infermierëve dhe nevoja për shtim të stafit është e domosdoshme.

Rritja e pagave varet nga politikat dhe buxheti

Revista: Çfarë masash do të ndërmerri për të ulur lodhjen dhe sindromën e djegies profesionale të stafit?

Lulzim Gashi: Riorganizimin e punës, shpërndarjen më të drejtë të ngarkesës dhe rritjen graduale të numrit të infermierëve.

Revista: A ka plan për përmirësimin e pagave dhe të kushteve të punës?

Lulzim Gashi: Do të kërkohet përmirësimi i pagave dhe i kushteve të punës, por kjo varet nga politikat dhe buxheti. Megjithatë, si institucion, do të ushtrohet presion i vazhdueshëm për këtë çështje.

Revista: Si do të ngritet niveli profesional i infermierëve?

Lulzim Gashi: Përmes trajnimeve të vazhdueshme, specializimeve dhe bashkëpunimeve me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Revista: A pritet standardizimi i procedurave në të gjitha klinikat?

Lulzim Gashi: Po. Standardizimi i procedurave është i domosdoshëm dhe do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Odën e Infermierëve.

Revista: Si do të matet performanca e infermierëve?

Lulzim Gashi: Përmes indikatorëve të qartë, si: cilësia e kujdesit, etika profesionale, angazhimi dhe reagimet (feedback-u) nga pacientët.

Zero tolerancë ndaj neglizhencës

Revista: Si do të trajtohen rastet e neglizhencës profesionale?

Lulzim Gashi: Do të ketë tolerancë zero ndaj neglizhencës, por çdo rast do të trajtohet me qasje profesionale, përmes analizës dhe përmirësimit të proceseve.

Revista: A do të ketë më shumë transparencë në vendimmarrje?

Lulzim Gashi: Po. Transparenca në vendimmarrje është prioritet.

Revista: Si do të përfshihet stafi infermieror në vendimmarrje?

Lulzim Gashi: Përmes takimeve të rregullta dhe përfaqësimit të tyre në grupet dhe strukturat vendimmarrëse.

Revista: Çfarë ndryshon për pacientin nga kjo qasje e re?

Lulzim Gashi: Pacienti do të përfitojë më shumë kujdes, komunikim më cilësor, më shumë kohë të dedikuar dhe ulje të gabimeve në trajtim.

Revista: Si do të matet cilësia e kujdesit infermieror?

Lulzim Gashi: Përmes indikatorëve klinikë, ankesave të pacientëve dhe nivelit të kënaqësisë së tyre.

Revista: A ka plane për përmirësimin e komunikimit infermier-pacient?

Lulzim Gashi: Po, përmes trajnimeve specifike dhe vendosjes së standardeve të qarta të komunikimit profesional.

Largimi i infermierëve me trend shqetësues

Revista: Pse po largohen infermierët nga Kosova dhe si mund të ndalet ky trend?

Lulzim Gashi: Arsyet kryesore janë kushtet e punës, pagat dhe mungesa e perspektivës. Zgjidhja qëndron në përmirësimin real të kushteve të punës, krijimin e mundësive për zhvillim profesional dhe vlerësimin më të drejtë të punës së tyre.

Revista: A mendoni se sistemi aktual i infermierisë ka dështuar?

Lulzim Gashi: Nuk mund të flasim për dështim total, por ka mangësi serioze që kërkojnë reformim dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Revista: Çfarë ju motivon në këtë pozitë?

Lulzim Gashi: Përmirësimi i sistemit dhe ndikimi pozitiv në kujdesin ndaj pacientëve.

Revista: Cila ka qenë sfida më e madhe në karrierën tuaj?

Lulzim Gashi: Menaxhimi i situatave me mungesë burimesh dhe nën presion të lartë, veçanërisht gjatë pandemisë COVID-19, kur kam udhëhequr Klinikën Infektive II në objektin e Mjekësisë Sportive, në cilësinë e kryeinfermierit.

Revista: Si e shihni rolin e infermierit në sistemin shëndetësor sot?

Lulzim Gashi: Roli i infermierit është kyç. Pa infermierë profesionalë, të motivuar dhe të organizuar, sistemi shëndetësor nuk mund të funksionojë në mënyrë efikase. Infermierët janë shtylla kryesore e kujdesit shëndetësor dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në sigurinë, mirëqenien dhe shërimin e pacientëve.



Infermierët mirëpresin sigurimet jetësore

Sigurimet jetësore nga infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësorë po konsiderohen një mburojë profesionale dhe financiare në sistemin shëndetësor

Xhavit Ramadani, Rexhep Jakaj

Gjilan, Ferizaj - Në një sistem shëndetësor ku kërkesat profesionale dhe rreziqet e përditshme janë të larta, infermierët mbeten një nga shtyllat kryesore të kujdesit shëndetësor. Përtej përkushtimit ndaj pacientëve, ata përballen çdo ditë me ekspozim ndaj sëmundjeve infektive, lodhjes fizike, stresit emocional dhe rreziqeve të papitura në vendin e punës. Në këtë realitet, sigurimet jetësore po marrin gjithnjë e më shumë rëndësi si një formë e domosdoshme e mbrojtjes profesionale dhe sociale.

Sipas praktikave të sigurimeve të ofruara për profesionistët shëndetësorë, sigurimet jetësore synojnë të ofrojnë mbështetje financiare në rastet e rënda jetësore, si vdekja, aksidentet në punë, sëmundjet profesionale apo paaftësia për punë. Në këto raste, përfituesit – zakonisht familjarët e të siguruarit – përfitojnë kompensime financiare që ndihmojnë në përballimin e

humbjeve ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit jetësor.

Në këtë drejtim, Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë shëndetësorë ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e një skeme mbrojtëse për anëtarët e saj, duke mundësuar qasje në sigurime jetësore kolektive. Kjo nismë shihet si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes sociale të profesionistëve shëndetësorë në Kosovë.

Mbrojtje financiare në raste të ndryshme rreziku

Skemat e sigurimeve për infermierët përfshijnë disa kategori përfitimesh, varësisht nga natyra e ngjarjes së siguruar. Ato përfshijnë kompensim për vdekje nga aksidenti, invaliditet, paaftësi si pasojë e lëndimeve

në punë, sëmundje onkologjike, sëmundje profesionale dhe sëmundje të rënda, si dhe për qëndrime spitalore me kohëzgjatje të ndryshme.

Në rast të ndodhjes së një ngjarjeje të siguruar, shumat e përfitimit ndryshojnë sipas kategorisë, duke filluar nga disa qindra deri në disa mijëra euro, varësisht nga rasti dhe kushtet e kontratës. Këto mjete financiare synojnë të zbusin barrën ekonomike në momentet më të vështira për infermierët dhe familjet e tyre.

Ndikimi psikologjik dhe profesional

Përveç aspektit financiar, sigurimet jetësore kanë edhe një ndikim të rëndësishëm psikologjik. Ndjenja e sigurisë për të ardhmen dhe për familjen e tyre ndihmon në uljen e stresit profesional dhe rritjen e



përkushtimit në punë. Infermierët që ndihen të mbrojtur janë më të fokusuar në ofrimin e kujdesit cilësor ndaj pacientëve dhe përballimin më të lehtë të sfidave të përditshme.

Zëri i profesionistëve shëndetësorë

Në praktikë, vetë infermierët e konfirmojnë rëndësinë e këtij mekanizmi mbrojtës.

Infermierja nga S.P i Gjilanit me mbi 20 vite përvojë, Leonora Selimi, thekson se sigurimet jetësore janë thelbësore për shkak të natyrës së rrezikshme të profesionit.

“Sigurimet e jetës janë jashtëzakonisht të rëndësishme për infermierët, sepse punojmë në një profesion me rreziqe të larta. Ato ofrojnë siguri financiare

për familjen në rast fatkeqësie apo sëmundjeje,” shprehet ajo, duke shtuar se mungesa e informimit mbetet një sfidë serioze.

Sipas saj, shumë infermierë nuk janë mjaftueshëm të informuar për përfitimet që ofrojnë këto sigurime, pasi shpesh janë të përqendruar në kujdesin ndaj pacientëve dhe jo në mbrojtjen e tyre personale.

Edhe në praktikën spitalore, kjo situatë konfirmohet nga infermierë me përvojë të gjatë.

Infermieri tjetër po nga ky institucion shëndetësor Ismajl Basha, me mbi 25 vite përvojë pune në repartin e emergjencës, thekson se rreziqet profesionale janë të përditshme.

“Ne jemi çdo ditë në kontakt me situata të paparashikueshme. Sigurimi i jetës është mbrojtje për familjen dhe një garanci për të ardhmen,” thotë ai, duke shtuar se ende pjesa më e madhe e kolegëve nuk e kanë të rregulluar këtë sigurim për shkak të kushteve ekonomike dhe mungesës së informimit.

Sfidat dhe nevoja për ndërgjegjësim

Të dy profesionistët pajtohen se një nga sfidat kryesore mbetet mungesa e informimit dhe edukimit financiar, si dhe nevoja për politika më të



qarta institucionale që mbështesin sigurimet kolektive për stafin shëndetësor. Po ashtu, theksohet rëndësia e fushatave ndërgjegjëse dhe trajnimeve profesionale për të rritur ndërgjegjen mbi këtë çështje.

Sigurimet jetësore për infermierët, sipas tyre, përfaqësojnë më shumë se një kontratë financiare, duke u shndërruar në një mekanizëm të rëndësishëm të mbrojtjes sociale, profesionale dhe familjare. Ato kontribuojnë në stabilitetin ekonomik, rrisin sigurinë psikologjike dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

Në një profesion ku kujdesi për të tjerët është mision i përditshëm, mbrojtja e vetvetes dhe familjes mbetet një domosdoshmëri që nuk duhet neglizhuar.





OIK siguron mbrojtje juridike dhe sigurime shëndetësore për anëtarët

Nga 1 korriku 2026, anëtarët e OIK-ut do të përfitojnë shërbime juridike dhe sigurime shëndetësore e të jetës, që mbulojnë kontestet e punës, çështjet pensionale, sëmundjet e rënda, trajtimet spitalore dhe rastet e aksidenteve.

Rexhep Jakaj

Prishtinë – Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK), nga muaji korrik i këtij viti, për anëtarësinë e saj do të fillojë së aplikuari një paketë të re shërbimesh juridike, si dhe sigurimesh shëndetësore e të jetës. Sipas drejtuesve të OIK-ut, iniciativa synon përmirësimin e gjendjes sociale dhe materiale të anëtarëve, duke garantuar mbrojtje më të madhe ligjore dhe siguri financiare në rastet e sëmundjeve apo aksidenteve.

Përmes një komunikate drejtuar anëtarëve, OIK ka bërë të ditur se, pas përpjekjeve të vazhdueshme të organeve të saj, ka arritur të sigurojë këto shërbime me kosto minimale financiare për komunitetin profesional që përfaqëson.

Shërbime juridike gjithëpërfshirëse

Paketa juridike përfshin përfaqësim dhe mbrojtje ligjore në një gamë të gjerë çështjesh. Anëtarët do të mund të përfitojnë nga përfaqësimi para gjykatave të të gjitha niveleve, prokurorive, insti-

tucioneve publike dhe organeve disiplinore.

Po ashtu, OIK do të ofrojë mbështetje juridike për rastet e cenimit të nderit, dinjitetit dhe integritetit profesional të anëtarëve, duke përfshirë përgatitjen e padive dhe përfaqësimin në procedurat për kompensim të dëmit material dhe jomaterial.

Ndihma ligjore do të shtrihet edhe në kontestet e punës, si: ndërprerja e kontratës së punës, procedurat disiplinore, diskriminimi, mospagesa e pagës dhe shkelje të tjera të të drejtave të punës.

Një tjetër komponent i rëndësishëm është përfaqësimi në procedurat që lidhen me pensionet, njohjen e stazhit të punës dhe kontestet me autoritetet pensionale. Përveç kësaj, anëtarët do të mbështeten edhe në rastet e ankesave dhe kontesteve që lidhen me konkurset publike dhe proceset e rekrutimit.

Sigurime për jetën dhe shëndetin

Paketa e sigurimeve do të mbulojë raste të ndryshme, përfshirë vdekjen nga aksidenti, vdekjen natyrale, vdekjen si pasojë e sëmundjeve profesionale, invaliditetin nga aksidenti, si dhe një sërë sëmundjesh të rënda.

Në listën e sëmundjeve të mbuluara përfshihen: ataku kardiak, ndërhyrjet e mëdha kardiokirurgjike, sulmi në tru, dështimi kronik i veshkave, sëmundjet onkologjike, si dhe gjendje të tjera serioze, si: paraliza, verbëria, shurdhëria, skleroza multiple dhe sëmundja e Alzheimerit.

Sigurimi do të mbulojë, gjithashtu, qëndrimin në spital, thyerjet e

kockave si pasojë e aksidenteve dhe kirurgjinë kozmetike të nevojshme pas aksidenteve.

Shumat e mbulimit

Sipas tabelës së publikuar nga OIK, shumat siguruese arrijnë deri në 4,000 euro për sëmundjet onkologjike, 3,500 euro për vdekjen nga aksidenti dhe sëmundjet profesionale, ndërsa invaliditeti nga aksidenti mbulohet deri në 1,500 euro.

Përfitime financiare parashihen edhe për qëndrimet spitalore, të cilat variojnë nga 100 deri në 200 euro, varësisht nga kohëzgjatja e trajtimit.

Ndryshime në pagesën e anëtarësisë

Për të siguruar financimin e këtyre shërbimeve, Kuvendi i OIK-ut ka miratuar një vendim të ri për anëtarësinë. Të punësuarit në sektorin publik do të vazhdojnë të paguajnë 0.5 për qind të pagës bruto përmes sistemit shtetëror të pagesave. Ndërkohë, anëtarët e papunë dhe ata të punësuar në sektorin privat do të paguajnë 3 euro në muaj, ndërsa pensionistët 2 euro në muaj.

Për këto kategori, pagesa do të realizohet në baza vjetore përmes platformës elektronike të OIK-ut, ku anëtarët mund të gjenerojnë faturën përkatëse.

Afati për përfshirje në skemë

OIK ka bërë të ditur se lista e përfituesve të sigurimeve dhe mbrojtjes juridike duhet të procedohet para hyrjes në fuqi të paketave. Për këtë arsye, anëtarët duhet t'i kenë përmbushur obligimet e tyre financiare përpara afatit të përcaktuar nga Oda.

Sipas njoftimit, mjetet e grumbulluara nga anëtarësia do të përdoren ekskluzivisht për mbulimin e kosteve të shërbimeve juridike dhe sigurimeve, me synimin që kontributi i anëtarëve të rikthehet në formën e përfitimeve konkrete për komunitetin profesional.

Drejtuesit e OIK-ut e kanë cilësuar këtë marrëveshje si një nga arritjet më të rëndësishme për mirëqenien e anëtarëve, duke vlerësuar se ajo do të sjellë mbështetje të drejtpërdrejtë në aspektin ligjor, shëndetësor dhe social për mijëra profesionistë shëndetësorë në vend.



Këshilli etik, mbrojtës i vlerave profesionale dhe dinjitetit në shëndetësi

Etika profesionale është themeli mbi të cilin ndërtohet besimi ndërmjet profesionistëve shëndetësorë dhe pacientëve. Për të kuptuar më mirë rolin e Këshillit Etik në Odën e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor, zhvilluam një bisedë me kryetaren e këtij organi, znj. Behare Alija, e cila flet për misionin, sfidat dhe rëndësinë e promovimit të kulturës etike në sistemin shëndetësor.

Lirije Beqiri

Prishtinë, qershor 2026

Etika profesionale mbetet një nga shtyllat më të rëndësishme të ushtrimit të profesionit në shëndetësi. Ajo udhëheq sjelljen e profesionistëve shëndetësorë, garanton respektimin e dinjitetit të pacientit dhe kontribuon në ndërtimin e besimit të publikut ndaj institucioneve shëndetësore. Brenda Odës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor, Këshilli Etik luan një rol kyç në mbrojtjen e standardeve profesionale dhe trajtimin e rasteve që lidhen me shkeljet etike. Në këtë intervistë, kryetarja e Këshillit Etik, Behare Alija, ndan pikëpamjet e saj mbi rëndësinë e etikës, sfidat me të cilat përballet ky organ dhe vizionin për të ardhmen.

Revista: E nderuara kryetare e Këshillit Etik të OIK-ut, fillimisht na tregoni pak për Këshillin Etik dhe rolin tuaj në këtë organ.

Behare Alija: Këshilli Etik është një organ profesional i Odës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor që vepron në mbrojtje të etikës, dinjitetit dhe standardeve profesionale. Në Kuvendin e OIK-ut, Legjislatura e III-të, me besimin dhe mbështetjen e delegatëve, jam zgjedhur kryetare e Këshillit Etik. Është një përgjegjësi e madhe dhe

një pozitë mjaft delikate, pasi lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e integritetit profesional dhe mbrojtjen e interesit publik.

Revista: Cili është misioni kryesor i Këshillit Etik?

Behare Alija: Misioni ynë është promovimi i etikës profesionale, ruajtja e dinjitetit të profesionit, mbrojtja e të drejtave të pacientëve dhe ngritja e vetëdijes profesionale. Gjithashtu, ne trajtojmë rastet e shkeljeve etike dhe profesionale, duke siguruar që standardet e profesionit të respektohen në çdo nivel të praktikës shëndetësore.

Etika si themel i profesionit dhe mbrojtjes së pacientit

Revista: Pse është kaq e rëndësishme etika në profesionin infermieror?

Behare Alija: Infermiera është një profesion human, i ndërtuar mbi kujdesin, dhembshurinë dhe respektin për dinjitetin njerëzor. Përveç kompetencave profesionale, infermierët duhet të demonstrojnë përgjegjësi morale dhe integritet në çdo veprim. Etika garanton që pacientët të trajtohen me profesionalizëm, pa diskriminim dhe me respekt të plotë për të drejtat e tyre.



Revista: Me çfarë lloj rastesh merret më së shumti Këshilli Etik?

Behare Alija: Rastet që trajtojmë lidhen kryesisht me shkelje të Kodit Etik, sjellje joprofesionale, mosrespektim të të drejtave të pacientëve, komunikim joetik, cenim të dinjitetit profesional dhe konflikte profesionale në vendin e punës. Çdo rast shqyrtohet me paanshmëri, profesionalizëm dhe konfidencialitet të plotë.

Revista: A kanë qytetarët mundësi të paraqesin ankesa në Këshillin Etik?

Behare Alija: Po, sigurisht. Çdo qytetar ka të drejtë të paraqesë ankesë ose shqetësim lidhur me sjelljen profesionale dhe etike të profesionistëve shëndetësorë. Kjo ndihmon në rritjen e transparencës, përgjegjësisë profesionale dhe besimit të publikut në sistemin shëndetësor.

Revista: Si ndikon puna e Këshillit Etik në cilësinë e shërbimeve shëndetësore?

Shkeljet kanë qenë të natyrave të ndryshme, nga ato më të lehta deri te rastet më serioze. Ajo që kemi vërejtur është se moshën dhe përvojën profesionale nuk kanë qenë faktorë përcaktues, pasi rastet kanë përfshirë kategori të ndryshme të stafit, nga vullnetarët e deri te profesionistët pranë pensionimit.

të mbështetjes institucionale. Një sfidë tjetër mbetet zhvillimi i vazhdueshëm profesional në fushën e etikës shëndetësore, i cili është thelbësor për ofrimin e kujdesit cilësor dhe respektimin e të drejtave të pacientëve.

Revista: Cili është mesazhi juaj për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë?

Behare Alija: Profesionin infermieror kërkon përgjegjësi të lartë, përkushtim dhe humanizëm. Përveç njohurive dhe aftësive profesionale, çdo profesionist duhet të demonstrojë respekt për dinjitetin e pacientit, empati, dhembshuri dhe integritet profesional. Zbatimi i parimeve etike dhe profesionale kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe në forcimin e besimit të pacientëve ndaj profesionit tonë.

“Infermiera nuk është vetëm një profesion, por një thirrje për t’i shërbyer njeriut me përkushtim, empati dhe zemër. Çdo veprim infermieror është një dëshmi e respektit për jetën, dinjitetin dhe mirëqenien e pacientit.”

Revista: Në fund, cili është vizioni juaj për të ardhmen e Këshillit Etik?

Behare Alija: Synimi ynë është të vazhdojmë forcimin e kulturës etike në profesionet shëndetësore, të rrisim ndërgjegjësimin për rëndësinë e Kodit Etik dhe të kontribuojmë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor më të sigurt, më të besueshëm dhe më human. Vetëm përmes profesionalizmit, përgjegjësisë, transparencës dhe respektit të pakushtëzuar ndaj dinjitetit njerëzor mund të ndërtojmë një mjedis ku pacienti mbetet gjithmonë në qendër të kujdesit tonë profesional.

Behare Alija: Puna jonë ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e standardeve profesionale dhe në krijimin e një ambienti më etik e më të sigurt për pacientët. Kur respektohen parimet etike, rritet cilësia e kujdesit shëndetësor, forcohet humanizmi në shërbim dhe rritet besimi i qytetarëve ndaj profesionistëve shëndetësorë.

Revista: Çfarë mund të na thoni për rastet që keni trajtuar deri më tani?

Behare Alija: Gjatë mandatit tonë, numri i rasteve të iniciuara ka qenë relativisht i kufizuar.

Sfidat dhe vizioni për forcimin e kulturës etike

Revista: Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballet Këshilli Etik?

Behare Alija: Ndër sfidat kryesore do të veçoja mungesën e raportimit të rasteve etike, njohuritë e pamjaftueshme për procedurat e paraqitjes së ankesave, vështirësitë në zbatimin praktik të vendimeve dhe mungesën e vetëdijes për rëndësinë e etikës profesionale. Gjithashtu, shpesh hasim frikë nga pasojat e raportimit dhe mungesë

Aktivitetet e OIK gjatë periudhës Janar - Qershor 2026



U përrua vënia e gurthemelit për objektin e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë

Më 13 janar është përruar vënia e gurthemelit për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, një projekt i rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve institucionale të organizatave profesionale në sektorin e shëndetësisë.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë Kryetarja e OIK-ut, Nexhmije Gori, kryetarët e odave të tjera profesionale, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Të pranishëm ishin ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, drejtori i SHSKUK-së, Elvir Azizi dhe ambasadori i Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz.

Gjatë ceremonisë u theksua rëndësia e këtij investimi për avancimin e rolit të odave profesionale dhe krijimin e kushteve më të mira për funksionimin e tyre. Objekti po ndërtohet me mbështetjen e

Qeverisë së Luksemburgut dhe pritet të shërbejë si hapësirë e përbashkët koordinimi dhe bashkëpunimi për të gjitha odat profesionale shëndetësore në Kosovë.



OIK dhe Posta e Kosovës nënshkruajnë dy marrëveshje të rëndësishme

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë dhe Posta e Kosovës kanë nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi, të cilat synojnë lehtësimin e shërbimeve administrative dhe financiare për anëtarët e Odës në të gjithë vendin.

Marrëveshja e parë parasheh ofrimin e shërbimeve universale postare, përmes së cilës Posta e Kosovës do të bëjë pranimin, shpërndarjen dhe dorëzimin e të gjitha dërgesave zyrtare të Odës, përfshirë licencat profesionale dhe dokumentacionin zyrtar. Kontrata trevjeçare garanton trajtim sipas standardeve ligjore postare dhe mundësi gjurmimi të dërgesave.

Ndërkaq, marrëveshja e dytë autorizon Postën e Kosovës për inkasimin e pagesave të anëtarësisë në të gjitha zyrat postare. Anëtarët mund të kryejnë pagesat me një komision fikse prej

0.50 eurosh për transaksion. OIK e ka vlerësuar këtë bashkëpunim si një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të shërbimeve dhe rritjes së efikasitetit administrativ.



Nderohet kontributi i punonjësve shëndetësorë ndër dekada

Më 16 shkurt, përfaqësues të OIK-ut morën pjesë në ceremoninë përkujtimore kushtuar stafit shëndetësor, e organizuar me rastin e Ditës Përkujtimore për Punonjësit Shëndetësorë.

Kryetari i Këshillit Drejtues të OIK-ut, Bashkim Mehmeti, së bashku me përfaqësues të odave të tjera profesionale, vendosi lule pranë obeliskut të ngritur në hyrje të QKUK-së, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin e punonjësve shëndetësorë ndër vite.

Gjatë aktivitetit u theksua se 16 Shkurti shërben si ditë reflektimi për sakrificën dhe përkushtimin e profesionistëve shëndetësorë, veçanërisht në periudha të vështira si lufta, vitet e nëntëdhjeta dhe pandemia COVID-19. Pjesëmarrësit vlerësuan rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ruajtjen e shëndetit publik dhe shërbimin ndaj qytetarëve.



U mbajt Kuvendi i VII-të i Legjislaturës së III-të të OIK-ut

Më 27 shkurt, OIK mbajti Kuvendin e VII-të të Legjislaturës së III-të, ku janë shqyrtuar dhe miratuar dokumente me rëndësi të veçantë për funksionimin dhe zhvillimin e Odës.

Punimet u hapën nga kryetarja e OIK-ut, Nexhmije Gori, e cila theksoi rëndësinë e forcimit të profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Debatet diskutuan raportet e punës dhe ato financiare për vitin 2025, si dhe planin e punës dhe financiar për vitin 2026.

Kuvendi miratoi një sërë rregulloresh të reja dhe plotësime ndryshime të akteve ekzistuese, përfshirë ato për licencimin, edukimin e vazhdueshëm profesional, stazhin themelor dhe mbikëqyrjen profesionale. Po ashtu, është miratuar rritja e mbështetjes financiare për anëtarët që pensionohen nga Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.



Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor

OIK krijon kanalin zyrtar në Viber

Me qëllim të përmirësimit të komunikimit me anëtarësinë, OIK ka lansuar kanalin e saj zyrtar në platformën Viber.

Përmes këtij kanali do të publikohen njoftime, aktivitete dhe informacione me interes për profesionistët shëndetësorë, duke mundësuar informim më të shpejtë dhe më efikas. Oda ka ftuar të gjithë anëtarët që t'i bashkohen kanalit për të qenë të informuar në kohë reale mbi vendimet, aktivitetet dhe zhvillimet më të fundit.

Ky hap konsiderohet pjesë e modernizimit të komunikimit institucional dhe afimit më të madh të Odës me anëtarët e saj.



Përfundoi me sukses sesioni pranveror 2026 për EVP

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë shëndetësorë ka përmbyllur me sukses Sesionin Pranveror 2026 për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, i cili u ofrua pa pagesë për të gjithë anëtarët e saj.

Programi, i akredituar me 12 pikë kredituese nga Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, u zhvillua online përmes platformës Zoom dhe mblodhi një numër të madh pjesëmarrësish nga sektori publik, privat dhe anëtarë të papunë.

Përmes këtij sesi, profesionistët shëndetësorë patën mundësinë të avancojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre profesionale, në përputhje me standardet bashkëkohore të praktikës shëndetësore. OIK vlerësoi interesimin dhe pjesëmarrjen e anëtarëve, duke theksuar se edukimi i vazhdueshëm profesional mbetet një ndër prioritetet kryesore për zhvillimin dhe avancimin e profesionistëve shëndetësorë në Kosovë.



OIK në trajnim për pozicionim strategjik

Gjatë muajit prill, OIK në bashkëpunim me IHS zhvilloi një trajnim dyditor me fokus në pozicionimin strategjik dhe angazhimin me palët e interesit.

Aktiviteti mblodhi përfaqësues të Odës për të diskutuar mënyrat e forcimit të rolit institucional dhe ndikimit në sektorin shëndetësor. Pjesëmarrësit u fokusuan në ndërtimin e partneriteteve më të forta, identifikimin e palëve kryesore të interesit dhe krijimin e një qasjeje më të strukturuar ndaj proceseve vendimmarrëse.

Kryetarja Nexhmije Gori theksoi se investimi në zhvillimin e kapaciteteve të brendshme mbetet thelbësor për rritjen e ndikimit dhe qëndrueshmërisë së Odës në të ardhmen.



Trajnimet për sigurinë në punë, menaxhimin e cilësisë, ndihmën e parë dhe mbrojtjen nga infeksionet

Rexhep Jakaj

Ferizaj, Maj/Qershor 2026 - Në kuadër të zhvillimit profesional dhe ngritjes së kapaciteteve të personelit shëndetësor, është organizuar një cikël trajnimesh profesionale për personelin shëndetësor, teknik dhe mbështetës, me qëllim përmirësimin e standardeve të punës, sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Programi i trajnimeve është realizuar me fokus në avancimin e njohurive dhe aftësive praktike në fushat e sigurisë dhe shëndetit në punë, sistemit të menaxhimit të cilësisë, ndihmës së parë dhe mbrojtjes nga infeksionet. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP), duke përfshirë fillimisht vozitësit, punëtorët e mirëmbajtjes, personelin teknik dhe inkasantët, ndërsa programi do të vazhdojë edhe me infirmierë, mjekë të radiologjisë

diagnostike, laborantë, personelin e emergjencës, farmacistë, vaksinimit, stomatologjisë dhe sektorëve të tjerë.

Siguria dhe shëndeti në punë

Siguria dhe shëndeti në punë përbëjnë elemente kyçe në mbrojtjen e personelit nga rreziqet profesionale dhe në krijimin e një ambienti të sigurt pune. Institucionet shëndetësore përballesh me ekspozim të vazhdueshëm ndaj rreziqeve biologjike, fizike, kimike dhe psikologjike. Përmes këtij trajnimi, pjesëmarrësit janë njohur me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, procedurat standarde të sigurisë dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës.

Trajnimet kanë trajtuar tema të ndryshme sipas profileve profesionale. Personeli shëndetësor është fokusuar në mbrojtjen nga infeksio-

net profesionale, lëndimet nga mjetet e mprehta dhe ekspozimin ndaj materialeve biologjike. Personeli i radiologjisë është trajnuar për mbrojtjen nga rrezatimi dhe përdorimin korrekt të pajisjeve mbrojtëse, ndërsa laborantët për trajtimin e sigurt të mostrave laboratorike dhe substancave kimike. Vozitësit dhe inkasantët kanë trajtuar sigurinë gjatë punës në terren, menaxhimin e stresit dhe parandalimin e aksidenteve, ndërsa punëtorët teknikë dhe të mirëmbajtjes janë fokusuar në mbrojtjen nga rrymat elektrike dhe përdorimin e sigurt të pajisjeve teknike.

Trajnimi është udhëhequr nga ekspertë dhe trajnerë të certifikuar, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e vetëdijes së stafit për rëndësinë e parandalimit të aksidenteve dhe ruajtjes së shëndetit në vendin e punës.



Sistemi i menaxhimit të cilësisë

Menaxhimi i cilësisë në institucionet shëndetësore është një proces i vazhdueshëm që synon ofrimin e shërbimeve të sigurta, efikase dhe profesionale për pacientët. Në kuadër të këtij trajnimi, pjesëmarrësit janë njohur me standardet moderne të menaxhimit të cilësisë, dokumentimin korrekt të proceseve të punës dhe përgjegjësinë profesionale në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar komunikimit profesional ndërmjet stafit dhe pacientëve, si dhe raportimit të incidenteve dhe gabimeve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit. Për personelin laboratorik dhe radiologjik është trajtuar kontrolli i cilësisë së rezultateve dhe mirëmbajtja e pajisjeve diagnostikuese, ndërsa për

sektorin teknik rëndësia e mirëmbajtjes preventive të pajisjeve mjekësore dhe infrastrukturës.

Ky aktivitet ka kontribuar në ngritjen e standardeve profesionale dhe forcimin e kulturës së cilësisë në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor.

Ndihma e parë dhe mbrojtja nga infeksionet

Ndihma e parë dhe kontrolli i infeksioneve janë komponentë thelbësorë të sigurisë shëndetësore. Pjesëmarrësit kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike për reagimin në raste emergjente, përfshirë gjakderdhjet, djegiet, frakturat, humbjen e vetëdijes dhe arrestin kardiak. Trajnimi ka përfshirë gjithashtu përdorimin e teknikave bazë të reanimimit dhe menaxhimin fillestar të pacientit deri në ndërhyrjen e ekipeve emergjente.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar parandalimit të infeksioneve profesionale dhe institucionale. Pjesëmarrësit janë trajnuar për higjienën e duarve, përdorimin korrekt të pajisjeve mbrojtëse personale, sterilizimin e instrumenteve dhe menaxhimin e mbeturinave mjekësore. Gjithashtu janë trajtuar dezinfektimi i sipër-

faqeve, trajtimi i sigurt i materialeve biologjike dhe zbatimi i masave higjienike në mjediset e punës dhe transportit.

Ky trajnim ka ndikuar në përmirësimin e gatishmërisë së stafit për



situata emergjente dhe në uljen e rrezikut të përhapjes së infeksioneve.

Përfshirja e profileve të ndryshme profesionale në një program të përbashkët trajnimi ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit multidisiplinar, ngritjen e përgjegjësisë kolektive dhe përmirësimin e sigurisë në vendin e punës. Aktivitetet e realizuara kanë krijuar një bazë të rëndësishme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe zbatimin e standardeve bashkëkohore në shërbimet shëndetësore.

Trajnimet për sigurinë dhe shëndetin në punë, menaxhimin e cilësisë, ndihmën e parë dhe mbrojtjen nga infeksionet kanë dëshmuar rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm profesional në sistemin shëndetësor. Në përfundim të programit, pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata, duke dëshmuar përkushtimin e tyre ndaj zhvillimit profesional dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimeve.



Diversiteti që forcon kujdesin shëndetësor

Rrëfimet e një infermieri nga komuniteti rom dhe një infermiereje nga komuniteti turk dëshmojnë se diversiteti, përkushtimi dhe profesionalizmi janë vlera që forcojnë sistemin shëndetësor dhe rrisin besimin e pacientëve.

Xhavit Ramadani

Sistemi shëndetësor i Kosovës po bëhet gjithnjë e më përfaqësues i shoqërisë shumëetnike të vendit. Infermierët dhe infermieret nga komunitetet minoritare jo vetëm që ofrojnë kujdes profesional për pacientët, por edhe shërbejnë si ura komunikimi dhe besimi ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shëndetësore. Një shembull i tillë janë Xhemajl Jashari nga komuniteti rom dhe Seven Rahimi nga komuniteti turk, të cilët punojnë në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit.

Nga sfidat personale drejt profesionit të respektuar

Për Xhemajl Jasharin, dëshira për t'i ndihmuar njerëzit ka qenë motivi kryesor që e ka orientuar drejt profesionit të infermierisë. Ai tregon se rruga drejt realizimit të këtij qëllimi nuk ka qenë aspak e lehtë, pasi është përballur me vështirësi sociale dhe paragjykime, por nuk është dorëzuar.

“Qysh në moshë të re kam pasur dëshirë të ndihmoj njerëzit. Rruga nuk ka qenë e lehtë për shkak të paragjykimeve dhe kushteve sociale, por me përkushtim dhe mbështetje nga familja arrita të përfundoj shkollimin për infermieri dhe të punësohem në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit,” thotë Jashari.

Ai kujton se integrimi në jetën profesionale ka pasur sfidat e veta. Në fillim, shpesh është përballur me pritshmëri më të ulëta ose me paragjykime të heshtura, por puna dhe profesionalizmi i tij kanë bërë që të fitojë respektin e kolegëve dhe pacientëve.

Sipas tij, përfaqësimi i komuniteteve në sistemin shëndetësor ka rëndësi të veçantë, pasi ndihmon pacientët të ndihen më të sigurt dhe më të kuptuar.

“Kur pacientët shohin dikë që i përfaqëson, ndihen më të pranuar dhe më të gatshëm të bashkëpunojnë. Për pacientët nga komuniteti rom, shpesh jam një urë lidhëse që i ndihmon të ndihen më të sigurt dhe të kuptuar,” shprehet ai.

Jashari beson se një sistem shëndetësor gjithëpërfshirës është më i drejtë dhe më efektiv për të gjithë qytetarët. Ai vlerëson se duhet të ketë më shumë politika dhe iniciativa që mbështesin komunitetet minoritare, si dhe më shumë trajnime për ndjeshmërinë kulturore në institucionet shëndetësore.

Diversiteti kulturor si urë komunikimi me pacientët

Një histori suksesi dhe përkushtimi vjen edhe nga infermierja Seven Rahimi. Ajo tregon se është rritur në një familje ku arsimit dhe kujdesit për të tjerët kanë qenë vlera themelore, duke u orientuar natyrshëm drejt profesionit të infermierisë.

“Që e vogël kam pasur dëshirë të punoj në shëndetësi. Kam përfunduar studimet për infermieri dhe tashmë prej vitesh punoj në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, profesion që e ushtroj me përkushtim dhe përgjegjësi,” thotë Rahimi.

Ajo thekson se integrimi në jetën profesionale ka qenë përgjithësisht pozitiv, megjithëse në fillim është përballur me pasiguri që lidhen me dallimet gjuhësore dhe kulturore. Me kalimin e kohës, përmes bashkëpunimit me kolegët dhe përvojës së fituar, është ndjerë gjithnjë e më e integruar në ambientin e punës.

Rahimi e konsideron ndjeshmërinë kulturore si një element thelbësor të profesionit të infermierisë.



“Çdo pacient vjen me vlera, besime dhe zakone të ndryshme. Njohja dhe respektimi i tyre ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e kujdesit. Kjo ndihmon në krijimin e besimit dhe bashkëpunimit më të mirë me pacientin,” shprehet ajo.

Sipas saj, infermierët nga komunitetet minoritare luajnë një rol të rëndësishëm në afrimin e shërbimeve shëndetësore me qytetarët. Përveç kujdesit profesional, ata ndihmojnë në kapërcimin e barrierave gjuhësore dhe kulturore, duke e bërë komunikimin më të lehtë dhe më efektiv.

“Pacientët nga komuniteti turk ndihen më të afërt me mua dhe shpesh më drejtohen më lirshëm, sidomos kur kanë vështirësi me gjuhën. Kjo më jep një rol shtesë si ndërmjetëse komunikimi,” thotë Rahimi.

Të dy profesionistët ndajnë të njëjtin mesazh për të rinjtë nga komunitetet e tyre: të investojnë në arsim, të besojnë në aftësitë e tyre dhe të mos heqin dorë nga ëndrrat. Ata vlerësojnë se identiteti kulturor duhet të shihet si një pasuri që pasuron sistemin shëndetësor dhe shoqërinë në tërësi.

Rrëfimet e Xhemajl Jasharit dhe Seven Rahimit dëshmojnë se profesionalizmi, përkushtimi dhe respekti për diversitetin janë vlera që forcojnë sistemin shëndetësor dhe kontribuojnë në ofrimin e një kujdesi më cilësor për të gjithë qytetarët.

Njohuritë e infermierëve rreth astmës bronkiale

Edona Ramadani – BSc Infermieri

Hyrje: Astma bronkiale është sëmundje kronike që karakterizohet me rritjen e sensibilitetit të trakesë, bronkeve dhe bronkiolve ndaj shkaktarëve të ndryshëm, e cila shoqërohet me ngushtim të theksuar të rrugëve të frymëmarrjes. Në vendet e zhvilluara, sot 1 në 4 fëmijë vuan nga astma bronkiale, pavarësisht shkakut apo tipit të saj. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), astma bronkiale është e renditur në vendin e gjashtë, duke u bërë kështu një barrë për individin (adultë e fëmijë), për familjen dhe ekonominë. Gjithashtu, është i rëndësishëm fakti se po evidentohen rritje të dukshme të sëmundjeve alergjike në moshën e fëmijërisë dhe në adoleshencë më shumë sesa në grupmoshat e tjera, çka, përveç problemit të madh shëndetësor, ka edhe një kosto të madhe ekonomike dhe sociale (Zhengguang H et al., 2020).

Aspektet e përgjithshme klinike të astmës bronkiale – Simptomat e astmës përfshijnë gulçim, kollë dhe fishkëllimë. Zakonisht, ajo shfaqet në fëmijëri dhe shpesh shoqërohet me gjendje të tilla si ekzema dhe ethet e barit. Ky aktivitet përshkruan vlerësimin dhe trajtimin e astmës, si dhe shpjegon rolin e ekipit ndërprofesional në menaxhimin e pacientëve me këtë gjendje. Astma është një gjendje në të cilën rrugët e frymëmarrjes ngushtohen dhe fryhen, duke prodhuar edhe jargë apo mukus shtesë. Kjo mund të vështirësojë frymëmarrjen dhe të

shkaktojë kollë, tingull fishkëllues gjatë frymëmarrjes dhe gulçim.

Shkaqet e përgjithshme të raportuara janë si në vijim: infeksionet virale të rrugëve të frymëmarrjes, aktiviteti fizik i sforcuar, sëmundja e refluksit gastro-ezofageal, sinusiti kronik, alergjenët mjedisorë, përdorimi i aspirinës dhe beta-blokuesve, tymi i duhanit, insektet, bimët, tymi dhe avujt e kemikateve të ndryshme, obeziteti, faktorët emocionalë ose stresi (Muhammad F et al., 2021).

Diagnostikimi diferencial i astmës bronkiale përfshin një sërë patologjish që ndajnë simptoma të ngjashme, si: bronkiti kronik dhe sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK), disfunksioni i kordave vokale – që mund të paraqitet me fishkëllima inspiratore, refluksi gastroezofageal (GERD) – që mund të shkaktojë kollë kronike dhe ndjesi djegieje, si dhe insuficienca kardiace kongjестive (IKK), veçanërisht tek të moshuarit, e cila mund të paraqitet me gulçim dhe fishkëllima.

Qëllimi i punimit dhe deklarimi i problemit: Qëllimi i këtij hulumtimi është vlerësimi i njohurive të infermierëve rreth astmës bronkiale. Profesionit infermierisë në vendin tonë, krahas të arriturave dhe avancimeve, i ka edhe mangësitë e veta, të cilat dita-ditës po tejkalohen dhe po tentohet që infermiera të jetë më e zhvilluar dhe të arrijë në një nivel më të lartë. Për këtë gjendje në

Kosovë, një pjesë të përgjegjësisë, me të drejtë, mund t'ia dedikojmë të kaluarës së vendit tonë, e cila, krahas të gjitha sferave, ka prekur edhe profesionin e infermierisë, duke lënë pasojë edhe në këtë profesion.

Problem në vete paraqet mungesa e punëtorëve – infermierëve në sistemin shëndetësor. Duke marrë parasysh se numri i pacientëve çdo ditë e më shumë është duke u rritur, shtohet edhe nevoja për rritjen e stafit infermieror. Krahas edukimit dhe shkollimit të gjenëratave të reja, një pjesë tjetër e problemit është se ka infermiere të shumtë të cilët ofrojnë informata dhe këshilla të ndryshme në bazë të eksperiencës dhe jo në bazë të njohurive profesionale.


Metodologjia: Të dhënat për këtë hulumtim janë grumbulluar nëpërmjet pyetësorit të standardizuar për astmën bronkiale, duke i përfshirë edhe të dhënat demografike (Halwani et al., 2016). Për mostër janë përzgjedhur infermiere nga sistemi shëndetësor publik në nivel primar dhe sekondar, me mostra të rastësishme nga vende të ndryshme urbane dhe rurale, pra nga Gjilani dhe rrethina.

Fillimisht janë printuar dhe shpërndarë 30 pyetësorë në dy nivelet e kujdesit shëndetësor. Plotësimi i pyetësorit nga pjesëmarrësit nuk ka marrë më shumë se 10–15 minuta. Pyetësori përmban gjithsej 18 pyetje, ku pesë prej tyre janë

për grumbullimin e të dhënave demografike, ndërsa 13 pyetjet e tjera kanë për qëllim identifikimin e njohurive të infermierëve në lidhje me astmën bronkiale. Pra, pyetësi ka qenë i fokusuar kryesisht në identifikimin e njohurive të infermierëve lidhur me astmën bronkiale.


Rezultatet: Nga të dhënat demografike të pjesëmarrësve kuptuam se gjinia femërore dhe ajo mashkullore, që vuajnë nga astma bronkiale, nuk kanë ndonjë dallim të theksuar sa i përket cilësisë së jetës. Ata jetojnë një jetë mesatarisht normale, por ekzistojnë dallime sa i përket shëndetit fizik ndërmjet gjinisë femërore dhe asaj mashkullore, ku gjinia mashkullore rezultoi të jetë fizikisht më e fuqishme sesa gjinia femërore.

A mendoni se pacientët me astmë mund të kenë aktivitetet të plota të...



Grafikoni nr.1 - A mendoni se pacientët me astma mund të kenë aktivitetet të plota të lidhura me shkollën

Sa jeni emocional kur pacienti ka frikë nga ndonjë sulm astmatik?



Grafikoni nr.2 - Sa jeni emocional kur pacienti ka frikë nga një sulm astmatik?

Profesionistëve shëndetësorë - Infermierëve iu është parashtruar


pyetja: a mendoni se pacientët me astma mund të kenë aktivitete të plota të lidhura me shkollën? E ata janë përgjigjur: Përherëshme 57.6%, butë 11.5%, mesatarisht 15.3% si dhe rëndë 15.3%.

Gjithashtu në pyetjen e parashtruar infermierëve se sa jeni emocional kur pacienti ka frikë nga një sulm astmatik, ata janë përgjigjur: Përherëshme 38.4%, butë 26.9%, mesatarisht 26.9%, si dhe rëndë 7.6%.

Për njohjen e simptomave të astmës bronkiale, profesionistëve shëndetësorë - infermierëve iu është parashtruar pyetja se frymëmarrja e vështirësuar a është simptomë e astmes bronkiale, ata janë përgjigjur: Përherëshme 34.6%, butë 19.2%, mesatarisht 23% si dhe rëndë 23%.


Shih graf.nr.3.

Frymëmarrja e vështirësuar a është simptomë e astmës bronkiale?



Grafikoni nr.3 - Frymëmarrja e vështirësuar a është simptomë e astmes bronkiale?

A mendoni se pacientët astmatik duhet t'i shmangen pluhurit?




Grafikoni nr.4 - A mendoni se pacientët astmatik duhet t'i shmangen pluhurit?

E sa i përket faktorëve të mjedisit, atyre iu është parashtruar pyetja a mendoni se pacientët astmatik

duhet t'i shmangen pluhurit, ata janë përgjigjur: Përherë 53.8%, butë 7.6%, mesatarisht 19.2% si dhe rëndë 19.2%.


Gjithashtu sa i përket faktorëve të mjedisit pjesëmarrësve iu është parashtruar edhe pyetja a mendoni se pacientët me astma bronkiale duhet t'i shmangen daljeve për shkak të motit ose ndotjes së ajrit, ata janë përgjigjur: Përherë 34.6%, butë 19.2%, mesatarisht 19.2% si dhe rëndë 26.9%.

A mendoni se pacientët astmatik duhet t'i shmangen daljeve për shkak të motit apo ndotjes së ajrit?



Grafikoni nr.5 A mendoni se pacientët me astma bronkiale duhet t'i shmangen daljeve për shkak të motit ose ndotjes së ajrit?

A ndikon astma bronkiale tek pacientët në karrierën e tyre?



Grafikoni nr.6 A ndikon astma bronkiale tek pacientët në karrierën e tyre?

Infermierëve iu është parashtruar edhe pyetja se a ndikon astma bronkiale tek pacientët edhe në karrierën e tyre, ata janë përgjigjur: Përherë 23%, butë 30.7%, mesatarisht 26.9% si dhe rëndë 19.2%.

Konkluzione:

• Sa i përket ndjeshmërisë emocionale të infermierëve kur pacientët përjetojnë sulme nga astma, 75% e tyre e përjetojnë këtë gjendje në mënyrë të butë.

• 35% e tyre kanë konfirmuar se pacientët dalin jashtë gjatë natës për të marrë frymë më lehtë.

• 13.8% e të anketuarve (infermierëve) janë deklaruar se astma u pengon atyre (pacientëve) edhe për të shkuar në punë.

• Sa i përket ndikimit të tymit të duhanit, pluhurit dhe faktorëve mjedisor 63.8% e infermierët mendojnë se ata ndikon negativisht në shëndetin e pacientëve.

• Ndërsa sa i përket ndikimit të astmës në kryerjen e aktiviteteve dhe rriteve fetare, 42.5% e tyre janë shprehur se ndikon në mënyrë mesatare.

Rekomandime:

Në bazë të të gjeturave të këtij hulumtimi, mund të rekomandojmë:

• Zhvillimin e mëtejshëm të studimit në vende dhe qytete të tjera të Kosovës, me qëllim të krijimit të një mostre më përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse, si dhe realizimin e një hulumtimi të kombinuar – kualitativ dhe kuantitativ.

• Përfshirjen e variablave të tjerë për të matur cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe për të krahasuar ato me cilësinë e jetës së personave të diagnostikuar me astmë bronkiale.

• Shfrytëzimin e të gjeturave për informim të infermierëve që të ketë përmirësim të cilësisë së shërbimeve shëndetësore brenda territorit të Kosovës.

• Përfshirjen aktive të infermierëve në krijimin e eksperiencës praktike dhe ofrimin e shërbimeve të mirëfillta shëndetësore për kujdesin, parandalimin dhe trajtimin e rasteve me astmë bronkiale.

Referencat:

Angelica T, (2018). Biomarkers in asthma: state of the art. *asthma res and pract* 4, 10 (2018). <https://doi.org/10.1186/s40733-018-0047-4>, publikuar me 2018.

Bateman E.D, Hurd S.S, Barnes P.J, Bousquet, J. Drazen M. FitzGerald, Gibson P, Ohta K, O'Byrne P, Pedersen S.E, Pizzichini E, Sullivan S.D, Wenzel S.E & Zar H.J, (2008). *Currnt impact factir, The European Respiratory Journal*, publikuar me 2008.

Dieter U, Liat & Wilhem-Bernhard N, (2008)., *Bronchial Asthma: Diagnosis and Long- Term Treatment in Adults*, PMID: PMC2696883, PMID: 19626179, 2008 May; 105(21): 385-394.

Halwani R, Al-kufeidy R, Muharib B, Alkhashram F, Hussain S, Alhenaki R, Vazquez-Tello A, Al-Frayh A, Iqbal S & Al-Muhsen S, (2016). *Journal of Lung Diseases & Treatment, Impact of Asthma on the Quality of Life of Adolescent Patients from Saudi Arabia, Lung Dis Treat* 2016, 2:3 DOI: 10.4172/2472-1018.1000114, publikuar me 2016.

Katzung, B. G., Kruidering-Hall, M., Vanderah, T. W., & Trevor, A. J. (2021). *Basic and clinical pharmacology (15th ed.)*. McGraw-Hill Education.

Muhammad F. Hashmi, Maryam Tariq & Mary E. Cataletto, (2021)., *Asthma, Continuing Education Activity, Last Update: August 14, 2021, Bookshelf ID:NBK430901* PMID: 28613651 publikuar me 2021.

Morris, M. J., Christopher, K. L., & Mathers-Schmidt, B. (2020). *Vocal cord dysfunction: Diagnosis and treatment. Chest*, 158(2), 401-408. <https://doi.org/10.1016/j.chest.2020.04.012>

National Asthma Education and Prevention Program (NAEPP). (2020). Focused updates to the asthma management guidelines: A report from the National Asthma Education and Prevention Program coordinating committee expert panel working group. Journal of Allergy and Clinical Immunology, 146(6), 1217-1270. <https://doi.org/10.1016/j.jaci.2020.10.003>

Pellegrino, R., Viegi, G., Brusasco, V., Crapo, R. O., Burgos, F., Casaburi, R., ... & Wanger, J. (2005). *Interpretative strategies for lung function tests. European Respiratory Journal*, 26(5), 948-968. <https://doi.org/10.1183/09031936.05.00035205>

Rabe, K. F., Watz, H., Baraldo, S., & Calverley, P. M. A. (2017). *Differentiating COPD and asthma: From epidemiology to management. Respiration*, 94(1), 3-14. <https://doi.org/10.1159/000477606>

Saetta M & Turato G, (2001). *Airway pathology in asthma, European Respiratory Journal* 2001 18: 18s-23s; DOI: 10.1183/09031936.01.00229501, publikuar me 2001.

Stephen T. Holgate, Sally W, Dirkje S, Scott T, Harald R & Peter D, (2015)., *Asthma, NCNI*, 2015; 1(1): 15025., Sep 10. doi: 10.1038/nrdp.2015.25, PMID: PMC7096989, PMID: 27189668, publikuar me 2015.

Zhengguang H, Juntao F, Junbo X, Qingguo W, Hong Y & Qianli M, (2020). *Frequency of Signs and Symptoms in Persons With Asthma, RespiratoryCare* February 2020, 65

(2) 252-264; DOI:<https://doi.org/10.4187/respcare.06714>, publikuar me 2020



Niveli i kënaqshmërisë në punë dhe performanca e Infermierëve në spitalin e Gjilanit

Sadije Ismaili – MSc, Menaxhim i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore

Hyrje: Fjala “infermiere” e ka origjinën nga fjala latine “Nutricius” që do të thotë dikush që ushqen, nxit dhe mbron. Roli i infermierëve në sistemin e kujdesit shëndetësor po zgjerohet dhe po ndryshon. Roli i tyre nuk kufizohet vetëm në kujdesin institucional, por përfshin edhe dhënien e shërbimeve në nivele të ndryshme të sistemit të kujdesit shëndetësor. Infermieret janë një nga shtyllat më të forta të sistemit të dhënies së kujdesit shëndetësor në ofrimin e shërbimeve të sigurt, të përballueshme dhe cilësore për njerëzit. Vdekshmëria, morbiditeti dhe reduktimi i aftësisë së kufizuar, promovimi i shëndetit nëpërmjet mënyrave të shëndetshme të jetesës janë rezultate pozitive shëndetësore në të cilat infermierët kanë një rol thelbësor (Akhter et al., 2021). Gjithashtu infermierët luajnë një rol integral në mjediset e kujdesit shëndetësor, duke ofruar kujdes për pacientët në ambulanca, spitale dhe klinika dhe duke ushtruar pozita dhe role të ndryshme brenda sistemit të kujdesit shëndetësor. Për shkak se infermierët kalojnë shumë kohë me pacientët, ata është e kuptueshme se edhe ndikojnë në kujdesin ndaj pacientit. Hulumtimet kanë treguar se mjedisi i punës së infermierëve është një faktor përcaktues. Kur pacientët kanë përvoja pozitive të kujdesit infermior edhe infermierët përjetojnë një mjedis të mirë, të shëndetshëm pune duke u bërë më të përkushtuar ndaj punës me pacient dhe ndaj profesionit të tyre (Cao & Naruse, 2019).

Kënaqshmëria në punë përshkruhet si perceptimi i individëve mbi përmbushjen e pritshmërive dhe nevojave personale në vendin e punës, duke përfshirë faktorë si mbështetja menaxheriale, kushtet e punës dhe marrëdhëniet ndërpersonale. Nga ana tjetër, performanca në punë matet si aftësia për të përmbushur me sukses detyrat dhe përgjegjësitë profesionale. Faktorët si mbingarkesa e punës, mundësitë për zhvillim profesional dhe vlerësimi i punës ndihmojnë në ndërtimin e një mjedisi që nxit performancën dhe përkushtimin (Laschinger et al., 2016).

Qëllimi i hulumtimit ishte të matet niveli i kënaqshmërisë në punë dhe performanca e infermierëve, respektivisht të testonte ndërlidhjen në mes të performancës së infermierëve dhe kënaqshmërisë në punë në spitalin e Gjilanit.

Metodologjia: Në hulumtimin është përdorur dizajn kuantitativ transvesal dhe është realizuar përmes një pyetësori të strukturuar. Në hulumtim morën pjesë 134 infermier të spitalit të Gjilanit. Moshë mesatare e tyre ishte 45 vjeç. Pjesëmarrësit janë rekrutuar me një mostrim të rastësishëm. Kriteret e pjesëmarrjes në hulumtim ishin infermier të punësuar në spitalin e Gjilanit dhe me përvojë në punën së paku një vit. Performanca e infermierëve në punë është matur me instrumentin Shkalla e matjes së performancës (The Performance measurement scale) e zhvilluar nga Ko, Lee, & Lim (2007). Ky instrument përbëhet nga 17 pyetje të cilat vlerësohen në shkallën Likert prej 1-5 pikë: 1-asnjëherë, 2-rrallëherë, 3-ndonjëherë, 4-shpeshherë dhe 5-gjithnjë.

Rezultatet: Sa i përket performancës si dhe kënaqshmërisë së infermierëve në S.P të Gjilanit i kemi këto rezultate:

Rezultati i performancës së infermierëve në Spitalin e Gjilanit

	Numri i frekuencave	Minimum i pikëve	Maksimum i pikëve	Mesatarja	Devijimi standard
Performanca e infermierëve	134	33	78	57	9.5

Rezultati i matjes së performancës së infermierëve në Spitalin e Gjilanit tregon se niveli i performancës së infermierëve në këtë spital është mesatarisht 57, me një devijimi standard prej 9.5. Performanca më e ulët është 33, ndërsa ajo më e larta është 78.

Rezultatet e matjes së kënaqshmërisë së infermierëve në spitalin e Gjilanit

	Numri i frekuencave	Minimum i pikëve	Maksimum i pikëve	Mesatarja	Devijimi standard
Kënaqshmëria e infermierëve	134	34	72	51.4	7.2

Rezultati i matjes së kënaqshmërisë së infermierëve në Spitalin e Gjilanit tregon se niveli më i ulët i kënaqshmërisë së infermierëve në punë është 34, kurse niveli më i lartë 72. Mesatarja prej 51.4 tregon mesataren e kënaqshmërisë në punë, ndërsa devijimi standard 7.2 që është një shpërndarje relativisht e ngushtë e rezultateve rreth mesatares.

E sa i përket shpërndarjes së rezultateve të performances te zbatimi i procesit infermior kemi këto rezultate:

Shpërndarja e rezultateve të performancës te zbatimi i procesit infermior

Zbatimi i procesit infermior		Asnjëherë	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjithnjë
Zbatimi i saktë i vlerësimit infermior duke përdorur instrumentet e formularit të informacionit infermior	N	1	29	10	52	42
	%	0.7%	21.6%	7.5%	38.8%	31.3%
Pas vlerësimit të pacientëve, planifikimi dhe zbatimi i kujdesit infermior sipas rendit të prioritetit	N	3	21	19	56	35
	%	2.2%	15.7%	14.2%	41.8%	26.1%
Demonstrimi dhe mësimi i aftësive të vetë-kujdesit për pacientët dhe familjet e tyre	N	11	29	6	60	28
	%	8.2%	21.6%	4.5%	44.8%	20.9%

Diskutimi: Hulumtimi i zhvilluar në spitalin e Gjilanit eksploroj nivelin e kënaqshmërisë në punë dhe performancën e infermierëve në spitalin e Gjilanit. Rezultatet ofruan një pasqyrë të qartë mbi faktorët kontekstual që nuk arritën pragun e signifkancës statistikore. Kjo sugjeron se, pavarësisht llojit të repartit, kënaqshmëria në punë e infermierëve mund të jetë e ndikuar nga faktorë më të gjerë organizativë ose kulturorë, sesa thjesht nga natyra e detyrave klinike.

Krahasimet me literaturën ndërkombëtare mbështesin këto gjetje, duke theksuar se performanca e infermierëve mund të jetë më e ndjeshme ndaj kushteve specifike të repartit, ndërsa kënaqshmëria në punë varet shpeshherë nga faktorë më kompleksë që lidhin këto dimensione të rëndësishme në kujdesin shëndetësor.

Rekomandime: Duke u bazuar në gjetjet dhe përfundimet e hulumtimit janë adresuar këto rekomandime:

Organizimi i programeve për vlerësimin e kontributit të infermierëve, si certifikata, mirënjohje apo shpërblime motivuese për përmirësim të performances së tyre..

Inkurajimi i infermierëve për të marrë pjesë në projekte hulumtuese që lidhen me vlerësimin dhe përmirësimin e praktikave të kujdesit infermior në spitale e që kjo rrit kënaqshmërinë e infermierëve.

Implementimi i këtyre rekomandimeve mund të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm dhe motivues për infermierët, duke rritur performancën dhe njëkohësisht përmirësuar kënaqshmërinë e tyre në punë. Kjo, në fund të fundit, do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së kujdesit infermior të ofruar për pacientët në spitalin e Gjilanit.

REFERENCAT

Aiken, L. H., Clarke, S. P., Sloane, D. M., Lake, E. T., & Cheney, T. (2008). Effects of hospital care environment on patient mortality and nurse outcomes. *Journal of Nursing Administration*, 38(5), 223-229.

Al-Homayan. (2013). Impacts of job performance level on nurses in public sector hospitals. *American Journal of Applied Sciences*, 10(9), 1115-1123.

Hasanah, R., & Maharani, C. (2022). Faktor-Faktor yang Berhubungan dengan Kinerja Perawat. *Indonesian Journal of Public Health and Nutrition*, 2(1), 75-82.

Hassmiller, S., & Cozine, M. (2019). Addressing the challenges of nurse satisfaction. *Health Affairs Blog*, among hospital nurses: A literature review. *International Journal of Nursing Studies*, 94, 21-31.

Hegazy, A., Ibrahim, M., Shokry, W., & El Shrief, H. (2021). Work environment factors in nursing practice. *Menoufia Nursing Journal*, 6(2), 65-73.

Hellín Gil, M. F., Ruiz Hernández, J. A., Ibáñez-López, F. J., Seva Llor, A. M., Roldán Valcárcel, M. D., Mikla, M., & López Montesinos, M. J. (2022). Relationship between job satisfaction and workload of nurses in Adult Inpatient Units. *International Journal of Environmental Research and Public Health*, 19(18), 11701.

Hidayat, A. A. A. (2017). Correlation Between Nurses' Job Satisfaction and Motivation, and Nurses' Performance in Indonesia: A Cross Sectional Study in Soewandi Hospital. *Advanced Science Letters*, 23, 12518-12520.

Ko, Y. K., Lee, T. W., & Lim, J. Y. (2007). Development of a performance measurement scale for hospital nurses. *Taehan Kanho Hakhoe chi*, 37(3), 286-294.

Lu, H., While, A. E., & Barriball, K. L. (2012). Job satisfaction among nurses: a literature review. *International Journal of Nursing Studies*, 49(8), 1017-1038.

Muwanguzi, E. (2022). Job Satisfaction: A Literature Review. *Journal of Research in Humanities and Social Science*, 10, 165-172.

Warr, P., Cook, J., & Wall, T. (1979). Scales for measurement of some work attitudes and aspects of psychological wellbeing. *Journal of Occupational Psychology*, 52, 129-148.

World Health Organization (WHO). (2019). Nursing and midwifery: Key facts. Retrieved from <https://www.who.int> [26.05.2024]

Njohuritë mbi fazën preanalitike nga stafi infermieror dhe laboratorik në SHSKUK – Prishtinë

MSc. Ass. Alma Vllasaliu

Hyrje

Faza preanalitike e testimit laboratorik përfshin të gjitha proceset dhe procedurat që zhvillohen përpara fazës analitike, duke përfshirë përgatitjen e pacientit, marrjen e mostrave, trajtimin, transportin dhe përpunimin e tyre. Kjo fazë vendimtare ka ndikim të rëndësishëm në cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve laboratorike, pasi gabimet ose devijimet gjatë saj mund të çojnë në diagnoza të pasakta, trajtim të vonuar ose të papërshtatshëm dhe dëmtim të mundshëm të pacientëve (Hakami et al., 2023).

Faza preanalitike konsiderohet pjesa më e cenueshme e procesit të përgjithshëm të testimit dhe paraqet një nga sfidat më të mëdha për profesionistët laboratorikë. Megjithatë, aktivitetet preanalitike, menaxhimi i mostrave të papërshtatshme dhe politikat e raportimit nuk janë plotësisht të standardizuara dhe të harmonizuara në nivel global (Simundic & Lippi, 2012).

Ekzistojnë standarde të ndryshme lidhur me marrjen, transportimin dhe trajtimin e mostrave të gjakut, por respektimi i tyre mbetet i ulët, veçanërisht jashtë laboratorit dhe kur marrja e mostrave kryhet pa mbikëqyrjen e drejt-përdrejtë të personelit laboratorik (Simundic & Lippi, 2012).

Cilësia e dobët e mostrës së gjakut përbën thelbin e variablave

preanalitike dhe kontribuon në 80–90% të gabimeve preanalitike. Kjo mund të manifestohet në formën e ndryshimeve biologjike in vitro në përbërjen e gjakut (p.sh., si rezultat i përgatitjes së papërshtatshme të pacientit para marrjes së mostrës) ose ndryshimeve in vivo (p.sh., si pasojë e marrjes dhe trajtimit të papërshtatshëm të mostrës). Sipas literaturës, mostrat e hemolizuara përbëjnë burimin kryesor të cilësisë së dobët të mostrave të gjakut (40–70%), të ndjekura nga vëllimi i papërshtatshëm i mostrës (10–20%), përdorimi i enës së gabuar (5–15%) dhe mostrat e mpiksura (5–10%) (Nordin et al., 2024).

Cilësia në diagnostikimin mjekësor është thelbësore për ofrimin e kujdesit shëndetësor të sigurt. Brenda disiplinave klinike, mjekësia laboratorike luan një rol jetik në garantimin e sigurisë së pacientit (Alavi et al., 2020).

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij hulumtimi është vlerësimi i nivelit të njohurive të personelit infermieror dhe laboratorik në SHSKUK – Prishtinë lidhur me fazën preanalitike, identifikimi i boshllëqeve në njohuri dhe evidentimi i fushave që kërkojnë përmirësim.

Objektivat e studimit janë:

- Të shqyrtohen faktorët që kontribuojnë në gabimet pre-

analitike në testimin laboratorik klinik.

- Të analizohen masat aktuale për reduktimin e këtyre gabimeve.
- Të rritet ndërgjegjësimi i profesionistëve shëndetësorë dhe personelit laboratorik për rëndësinë e fazës preanalitike.
- Të promovohet bashkëpunimi në zbatimin e praktikave të mira laboratorike për sigurimin e saktësisë dhe besueshmërisë së rezultateve diagnostikuese.

Metodologjia

Ky studim ka karakter deskriptiv. Të dhënat janë mbledhur nga 90 pjesëmarrës, kryesisht personel infermieror dhe laboratorik nga klinikat e SHSKUK-së në Prishtinë. Janë përdorur dy pyetësorë, ndërsa pyetësori kryesor përbëhej nga 25 pyetje të strukturuar mbi aspekte të ndryshme të fazës preanalitike, si përgatitja e pacientit, marrja e mostrave, trajtimi, transporti dhe ruajtja e tyre.

Rezultatet

Studimi shqyrtoi njohuritë, përvojën dhe praktikën e stafit shëndetësor në fazën preanalitike të testimit laboratorik. Pjesëmarrësit përbëheshin nga infermierë (74.4%) dhe staf laboratorik (16.7%), ndërsa shumica kishin 4–6 vjet përvojë pune.

Sa i përket nivelit arsimor, 61% e stafit laboratorik kishin diplomë bachelor, ndërsa 22% e infermierëve kishin përfunduar vetëm arsimin e mesëm. Rreth 28.9% e pjesëmarrësve raportuan se kishin ndjekur trajnime përkatëse, ndërsa 62.2% deklaruan se nuk kishin marrë trajnim.

Shumica e pjesëmarrësve (67.8%) raportuan se kishin njohuri mbi protokollet e standardizuara. Rezultatet e testimit të njohurive varionin nga 0 deri në 12 pikë, me një mesatare prej 5.36 (SD = 2.66), duke treguar një nivel mesatar të njohurive.

Testi t për mostra të pavarura tregoi se nuk kishte dallim statistikisht domethënës ndërmjet infermierëve (M = 5.31, SD = 2.61) dhe stafit laboratorik (M = 5.00, SD = 2.80), $t(19.82) = 0.40$, $p = .696$.

Fjalët kyçe: faza preanalitike, gabimet laboratorike, trajnimi i stafit, laboratorik klinik.


Konkludimet

Rezultatet e këtij studimi nënvizojnë rëndësinë e fazës preanalitike për cilësinë dhe besueshmërinë e testeve laboratorike. Gjetjet sug-


jerojnë se edukimi i vazhdueshëm dhe zbatimi i protokolleve të standardizuara janë të domosdoshme për parandalimin e gabimeve laboratorike në këtë fazë.

Gabimet më të zakonshme që ndikojnë në saktësinë e rezultateve laboratorike përfshijnë etiketimin e gabuar të mostrave, marrjen jo të duhur të tyre, si dhe transportin dhe ruajtjen e papërshtatshme. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve theksuan nevojën për trajnime shtesë dhe burime praktike për përmirësimin e njohurive dhe praktikave profesionale.

Grafikon i Rezultateve të Njohurive



Grafikoni 1. Rezultatet e përgjithshme të njohurive



Grafikoni 2. Pjesëmarrja demografike



SIGURIMI I JETËS DHE SIGURIMI SHËNDETËSOR

Përfitimet nga anëtarësimi në OIK

PËRFSHIN MBROJTJE NË RASTET:

- I Vdekje për shkaqe aksidenti
- II Vdekja e shkaktuar nga sëmundjet profesionale
- III Vdekje natyrale (si pasojë e sëmundjeve të ndryshme)
- IV Pa aftësi – Invaliditeti për shkak të aksidentit
- V Kompensim për sëmundjet e rënda
- VI Sëmundjet Onkologjike
- VII Kirurgji kozmetike për shkak të pasojave të aksidentit.

SËMUNDJET E RËNDA PËRFSHIJNË:

- 1 Atak kardiologjik
- 2 Kardiokirurgji (Intervenim i hapur), Intervenim i aortës, kirurgji by-pass i aortës, Implantim të valvulës së zemrës, verbëri, shurdhëri, sklerozë multiple, djegie e shkallës së tretë, paralizë, sëmundje alzhajmer, gjendje kome.
- 3 Sulm në tru
- 5 Dështim kronik të veshkëve
- 6 Qëndrim në spital
- 7 Thyrje e kockave për shkak të aksidentit.

KOMPENSIMI BËHET SIPAS SHUMAVE TË MË POSHTME

Nr.	Përshkrimi	Shumat Siguruese
1	Vdekje nga aksidenti	€ 3,500
2	Invaliditet nga aksidenti	€ 1,500
3	Pa aftësi nga lëndimi në punë	€ 3,000
4	Sëmundje onkologjike	€ 4,000
5	Vdekje nga sëmundje profesionale	€ 3,500
6	Vdekje natyrale (deri në moshën 65 vjeç)	€ 1,000
7	Sëmundje të rënda nga pika -V-	€ 750
8	Qëndrim spitalor 7 - 14 ditë	€ 100
9	Qëndrim spitalor 15 - 21 ditë	€ 150
10	Qëndrim spitalor mbi 22 ditë	€ 200
11	Kirurgji kozmetike si pasojë e aksidentit	€ 250

PËR TË FITUAR BENEFITET E SIGURIMIT, ANËTARI I ODËS DUHET TË KRYEJ KËTO OBLIGIME:

- ✓ Të jetë së paku një vit anëtarë i OIK
- ✓ Të jetë parapagues i rregullt i anëtarësisë
- ✓ Të mos jetë i dënuar me vendim të plotëfuqishëm gjyqësorë, për shkelje etike – profesionale, dhe të mos jetë i dënuar për shkelje të rënda nga OIK.



OIK – Mbrojtje, Siguri dhe Përfaqësim për çdo profesionist shëndetësor!



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës

Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



SIGURIMI I JETËS për anëtarët e OIK

Ju njoftojmë se anëtarët të cilët kanë përmbushur obligimet e anëtarësisë ndaj OIK-ut brenda afatit të përcaktuar janë përfshirë në skemën e sigurimit të jetës, e cila hyn në fuqi më **01 Korrik 2026**.



Për finalizimin e procedurës së regjistrimit dhe aktivizimin e mbulimit të sigurimit, është e domosdoshme plotësimi i Pyetësorit Shëndetësor.
Linku për plotësimin e pyetësorit i është dërguar secilit përfitues përmes email-it të regjistruar në sistem.



PLOTËSIMI I PYETËSORIT DUHET TË BËHET MË SË LARGU DERI MË 25 QERSHOR 2026.



Për detaje të tjera, ju lutemi referojuni email-it të cilin e keni pranuar, si dhe profilin tuaj në platformën online, në menyne "Benefitet nga anëtarësia".



Skema e sigurimit mbulohet nga OIK dhe nuk ka kosto shtesë për anëtarët përfitues.



Sigurimi i jetës për anëtarët e OIK

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës

Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

MBROJTJA LIGJORE

Përfitimet nga anëtarësimi në OIK



OIK-u ofron për të gjithë anëtarët mbrojtje ligjore FALAS, duke mbuluar 100% të shpenzimeve.



1. Mbrojtje profesionale për ushtrimin e padive për dëmshpërblim në rast të shkeljes së nderit, dinjtetit dhe integritetit profesional.



2. Mbrojtje ligjore në të gjitha çështjet që burojnë nga marrëdhënia e punës.



3. Mbrojtje ligjore në procedurat që lidhen me realizimin e të drejtës për pension.



4. Mbrojtje ligjore në kontestet që lidhen me proceset e konkurseve.



5. Përfaqësimi në Gjykatë në të gjitha çështjet juridike që lidhen me profesionin dhe të drejtat e anëtarit.



Në çdo rast nevojë për këto shërbime, drejtohuni pranë Zyrës Ligjore të OIK-ut, si dhe pranë avokatit Faton Fetahu.



Zyra Ligjore e OIK-ut



Avokat: Faton Fetahu



OIK – Mbrojtje, Siguri dhe Përfaqësim për çdo profesionist shëndetësor!

